

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENJUARA
FUSHATA ZGJEDHORE PER KUVENDIN E SHQIPERISE 2013
PERIUDHA 23.06.2013

**RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENJUARA NGA PARTIA
“Partia Socialiste e Moderuar”**

Tirane më, 10 Shtator 2013

Tabela e përmbajtjes

RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR
PASQYRA E TË ARDHURAVE (Financimet dhe Donacionet)
PASQYRA E SHPENZIMEVE (Përdorimi i fondeve sipas destinacionit)
INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Referencat ligjore:

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë "Partia Socialiste e Moderuar".

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA
FUSHATA ZGJEDHORE PER KUVENDIN E SHQIPERISE 2013
PERIUDHA 23.06.2013

Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Une kam audituar pasqyrën (deklaratën) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Sociliste të Moderuar për zgjedhjet parlamentare të kuvendit të Shqipërisë për periudhën 23.06.2013.

Pasqyra eshte pergjegjesi e drejtimit te subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Moderuar.

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia Sociliste e Moderuar bazuar në librin e llogarive të Partisë dhe të rregjistrin të posaçëm, miratuar si model me vendimin e KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore , që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtim – pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të veçantë me SNA 800 “Konsiderata të vecanta – auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qellime specifike’. Këto standarte kërkojnë që unë të veproj në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikoj e të kryej auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të kuvendit të Shqipërisë të mos përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshire vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale, qofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve , audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të Partisë në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare , me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të nevojshme për rrethanat financiare, por jo me qëllimin që të shprehë një opinion për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të partisë.

Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare, vlerësimin e përshtatshmërisë së

metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi i Partia Sociliste e Moderuar si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që unë kam siguruar është e mjaftushme dhe e përshtateshme për të dhënë një bazë opinionin tim të auditimit.

Detyra e subjektit zgjedhor Partia Sociliste e Moderuar është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave. Dokumentat që justifikojnë shpenzimet e mesiperme sipas natyres janë pjesërisht të rregullta dhe në përputhje me kërkesat e përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 90 të ligjit nr.10019 datë 29.02.2008 *Kodi Zgjedhore i Republikës së Shqipërisë*. Auditimi i shpenzimeve u realizua në analizë të tyre në krahasim me dokumentin justifikues të paraqitur nga subjekti zgjedhore.

Për mendimin tim, pasqyra e bashkëlidhur e fondeve të përfituar dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partia Sociliste e Moderuar e datës 23.06.2013, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën arkëtimeve dhe pagesave konform me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar 'Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'.

Vullnetare Hoxha

Eksperte Kontabile e Rregjistruar

Tiranë , më 08.09.2013

Permbajtja e Raportit te Veçante I auditit te pavarur

Informacione te Pergjitheshme

Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni eshte marre ne referim te ligjeve:

- Ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor I Republikes se Shqiperise”
- Ligji nr. 8580, date 17.02.2000 “Per partite politike” I ndryshuar
- Ligji nr. 10091, date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimit e profesionit te Ekspertit Kontabel te rregjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar”, Standarteve Nderkombetare te Auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligjit nr. 9228, date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”
- Çdo document ligjor te marre prane Partise Socilaiste te Moderuar.

Te dhena te pergjitheshme mbi subjektin Zgjedhor.

Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Moderuar” e ka fituar zotesine juridike per te vepruar, me vendimin nr. 420, date 28.01.2011 te Gjykates se Rrethit Tirane. Veprimtari e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit nr. 8580, date 17.02.2000 “Per partite politike”, ligjit nr. 8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese”, te ligjit nr. 8779, date 07.05.2001 “Per Rregjistrimin e Organizatave Jofitimpruese”, nga statute I saj dhe nga legjislacioni ne fuqi.

Subjeti zgjedhor “Partia Socialiste e Moderuar” eshte nje organizate shqiptare e cila ushtron veprimtarine e saj ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

Qendra e selise se Partise eshte ne bulevardin Zogu I Pare, Qendra Tregetare Tirana, kati I pare te Stacioni I Trenit.

Qellimi I krijimit:

Partia Socialiste e Moderuar eshte nje bashkim vullnetar I shtetasve shqiptare mbi bazen e grupimeve sociale, personave te moshes se trete , te papuneve, jetimeve dhe grupime te tjera sociale ne risk per t’u bere factor te vetevetes ne krijimin e nje partie te re politike, te bindjeve, te pikpamjeve dhe interesave te perbashketa te cilet synojne te ndikojne ne jeten e vendit nepermjet pjesemarrjes ne zgjedhjet dhe perfaqesimit te popullit ne organet e zgjedhura te pushtetit.

Burimet e Financimit jane:

- Te ardhurat nga kuotizacionet
- Te ardhurat nga buxheti I shtetit ne perputhje me legjislacionin per fiancimin e partive politike

- Ndimat dhe dhuratat e perkrahesve te PSM
- Ndimat dhe dhuratat e organizatave partnere
- Cdo e ardhur tjetere qe nuk bie ne kundershtim me legjislacionin per financimin e partive politike

Ne vazhdim te nenit 15 te statusit percaktohen rregullat e kontrollit te brendshem te parties per administrimin e fondeve si me poshte:

- Neni 15.2 Veprimtaria financiare dhe ekonomike e PSM drejtohet nga financieri I PSM.
- Neni 15.3 Financieri I PSM zgjidhet nga Komiteti drejtus Kombetar per periudhen kater vjecare, nepermjet konkurimit me kandidatura alternative dhe nuk mund te zgjidhet ne forumet drejtuse te parties.
- Neni 15.4 Aktiviteti financiar dhe ekonomik I PSM mbikqyret ne menyre te vazhdueshme nga Kryesia e cila cdo muaj dhjetor miraton buxhetin e PSM per vitin pasardhes.
- Neni 15.5 Nje here ne vit , ne mbledhjen e Komitetit Drejtus Kombetar, financier paraqet nje raport ne lidhje me aktivitetin ekonomik dhe financiar te PSM.
- Neni 15.6 rregullat e hollesishme mbi aktivitetin ekonomik dhe financiar te PSM miratohen nga Komiteti Drejtues Kombetar.

Organet Drejtuse te Qendres jane:

- Kongresi zgjedhor
- Komiteti Drejtus Kombetar
- Kryesia
- Kryetari
- Zvendeskryetari
- Sekretari I Pergjithshem

Kryetar I PSM eshte zgjedhur z. Gjergj Koja, I cili eshte I autorizuar te ndjeke te gjitha procedurat e nevojshme per aktivitetin normal te "Partise Socialiste e Moderuar.

Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabile.

Menyra e pergatitjes se Pasqyrave Financiare.

- a) Pasqyrat financiare jane pergatitur ne te gjitha aspektet e tyre material, ne perputhje me normat kontabile te raportimit financiar, te cilat perfshijne rregullat e percaktuara ne ligjin nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standarteve Kombetare te Kontabilitetit. Pasqyrat e paraqitur ne raport jane shprehur ne monedhen vendase ne Leke.

- b) Rregullat per vleresimin e kerkesave per arketim dhe te detyrimeve .
Kerkesat per arketim jane te pasqyruara mbi bazen e vleres se faturave origjinale te leshuara nga klientet apo te dokumentave te tjere kontabel. Detyrimet jane njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave te tjere origjinale.
- c) Rregullat e vleresimit te likujditeteve
Gjendjet e likujditeteve perfshijne gjendjen e parave ne arke dhe ne llogarive rrjedhese ne banke ne leke. U kontrolluan veprimet e kryera ne arke dhe ne banked he u konstatuan se rregjistrimet ne librat e llogarive dhe ne ditaret perkates ishin kryer sipas normave kontabel. Terheqjet nga banka perputheshin me hyrjet ne arke.
- d) Te ardhurat
Te ardhurat rregjistrohen sipas mases se realizimit te tyre nga donatoret dhe perdorimi I tyre eshte sipas planit te buxhetit te financuar nga projekti.

Organizimi I kontabilitetit.

Kontabiliteti eshte I organizuar ne perputhje me ligjin nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Fianciare" . Qendra ka ndertuar nje plan te llogarive vetjake ne perputhje te plote me SKK. Kontrolli I brendshem kryhet nga dega e Finances. Kontabiliteti mbahet ne menyre manuale.

Eksperte Kontabile e Rregjistruar

Vullnetare Çela (Hoxha)

PARTIA “SOCILAISTE E MODERUAR”
PASQYRA E ARKËTIMEVE PAGESAVE TË BËRA PËR FUSHATËN ZGJEDHORE
23.06.2013

Përshkrimi	Lekë
A- Të Ardhurat	0
Fondi financiar nga buxheti për fushatën zgjedhore	61,321
Fondi i dhënë në momentin e krijimit partisë	0
Fonde të dhuruara nga persona fizik për fushatë	1,429
Fonde të përftuara nga persona Juridik për fushatë	0
Totali të ardhurave, burimeve, (arkëtimeve)	62,750
B- SHPENZIME PËR FUSHATËN (deri më 23.06.2013)	0
1- Hapësire publicitare	0
2- Shpenzime telefonike e postare	
3- Postera	18,500
4- Shtypshkrime	
5- Stampime për publicitet	14,250
6- Qera ambjenti e zyre.	30,000
7- Të tjera	
Totali i shpenzimeve	62,750

Kryetari I Partise Socialiste te Moderuar
Gjergj Koja

